



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

D1 Nr./Br. 413/01-116/19
Data/Datum 11.05.2021
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

ANEKS

PËR

NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E MEMORANDUM BASHKËPUNITIT

në mes të

Komunës së Gjakovës, përfaqësuar nga z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës

dhe

OJQ Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptanëve, përfaqësuar nga z. Isak Skenderi, Drejtor Ekzekutiv

Neni 1

NDRYSHIM PLOTËSIM I MEMORANDUM BASHKËPUNITI

Duke u bazuar në marrëveshjen e nënshkruar në mes të OJQ-Zëri i Romëve Ashkalinj dhe Egjiptian dhe Komunës së Gjakovës me datën 09.07.2020 e cila zgjati deri në dhjetor të vitit 2020 me numër të protokollit të Komunës e Gjakovës 413/01-14804, dhe me numër protokollit të OJQ- Zëri i Romëve Ashkalinj dhe Egjiptian: 232/2020 e cila si qëllim ka pasur përmirësimin e kushteve të jetesës dhe banimit të grupeve te marginalizuara me fokus tek romët, ashkalinj dhe egjiptian për përmirësimin e situatës së tyre sociale në Komunën e Gjakovës.

Me qëllim të ekzekutimit të Memorandumit të Bashkëpunimi të datës 09.07.2020, bëjmë këtë ndryshim plotësim të Memorandum Bashkëpunimit, përkatësisht nenin 2 - Kushtet e përgjithshme si dhe neni 5 – Kohëzgjatja.

Neni 2

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Përfshirjen e Romëve dhe Ashkalive 2017-2021, dhe Planit Lokal të Veprimit të Komunës së Gjakovës, i cili mbështetet me projektin Drejtësia Sociale të zbatuar nga OJQ - Zëri i Romëve, Ashkalinj dhe Egjiptian në bashkëpunim me Fondacionin Zviceran HEKS dhe Fondacionin Zviceran Terre Des Hommes, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Prishtinë.

Komuna e Gjakovës në vitin 2020 nuk ka mundur të përmbushë një pjesë të nenit 2 për nënshkrimin e kontratës me kompaninë për furnizim me material ndërtimor, siç ka qenë e paraparë në Memorandum Bashkëpunimi të datës 03.07.2020.



Bazuar në nenin 2 të Memorandum Bashkëpunimi të datës 03.07.2020, specifikohet shuma e investimit e cila do të realizohet nga OJQ - Zëri i Romëve, Ashkalinj dhe Egjiptan me total 20.000.00 € dhe Komuna e Gjakovës duhet të ndaj 20.000.00 €.

Vlerë e shumës prej 20.000.00 €, OJQ- Zëri i Romëve Ashkalinj dhe Egjiptan gjatë vitit 2020 ka investuar 6.600 €, ndërsa për vitin 2021 do të investojë 13.400 € si pjese e mbetje. Këto mjete, OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinj dhe Egjiptan do ti transferoj në xhirollogarinë e Komunës së Gjakovës. Kësti i parë nga OJQ- Zëri i Romëve Ashkalinj dhe Egjiptan është transferuar tek Komuna me vlerë 6.600 në vitin 2020. Ndërsa kësti i dytë dhe i tretë do të realizohen duke u bazuar në nenin 2 nga Memorandum e Bashkëpunimit i nënshkruar në vitin 2020.

Neni 3 KOHËZGJATJA

Bazuar në neni 5 Kohëzgjatja e Memorandum Bashkëpunimi të datës 03.07.2020, ashtu që ndryshohet dhe plotësohet Memorandum Bashkëpunimi në mes të Komunës së Gjakovës dhe OJQ-Zëri i Romëve Ashkalive dhe Egjiptan , vazhdohet kohëzgjatja deri në dhjetor të vitit 2021.

Neni 4

PËRGJEGJËSITE DHE OBLIGIMET

Përgjegjësitë dhe obligimet të tjera që nuk janë cekur në këtë aneks e OJQ-VoRAE dhe të Komunës së Gjakovës mbeten të njëjta nga nënshkrimi i dokumentit të parë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me numër protokollit të komunës së Gjakovës 413/01-14804 të datës 03.07.2020 si dhe OJQ - Zëri i Romëve Ashkalinj dhe Egjiptan me numër protokollit 232/2020.

Neni 5 HYRJA NË FUQI

Aneks dokumenti i marrëveshjes së bashkëpunimit miratohet nga të dyja palët partnere dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit, më 11/05/2021 dhe është e plotfuqishme deri me 30/12/2021 ku do të ndahet për secilën palë nga një kopje origjinale.

Isak Skenderi



Drejtor Ekzekutiv

OJQ Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptanëve

Ardian Gjini



Kryetar i Komunës së Gjakovës

Maj, 2021